



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.631/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gshi Alaj kryesuese, Ramush Bardiqi dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik, Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, e parashtruar kundër subjektit politik, Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj, ndaj rezultateve të QNR-së për votat e diasporës më postë të datës 04.03.2025 të orës 16:09, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa A.nr.631/2025 datë 05.03.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, kundër subjektit politik Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj, ndaj rezultateve të QNR-së për votat e diasporës me postë të datës 04.03.2025 të orës 16:09, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, të parashtruar kundër subjektit politik, Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj me të cilën pretendohet se subjekti politik PDAK-LPB i konteston votat e diasporës me postë për subjektin PAI për këto arsye se, Orkestrimi i votave ku shihen qartë që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë, Votimi ne grupacione nga përfaqësues të PAI-së, Mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt ne rezultatin e votimit përmes marrjes se letërnjoftimit, hapjes se e-mailit dhe dëftesës nga PAI. Subjekti politik PAI dhe anëtarët e saj kanë bërë orkestrim të votave duke ndikuar direkt të votuesit dhe kjo mund të vërtetohet duke marr për bazë fletëvotimet ne KQZ të ardhur përmes postes e ku shihet se aty janë votuar vetëm kandidatet Artan Asllani me nr. 2 dhe Besart Jashari nr. 4 nga subjekti i PAI-së. PZAP mund të merr

votat në qendrën e numërimit sipas vendvotimeve si: VP/06 Istog 3 vota, VP/08 Klinë 3 vota, VP/09 Fushë Kosovë 30, VP/II Mitrovicë e Jugut 4 vota, VP/13 Lipjan 12 vota, VP/15 Obiliq 4 vota, VP/17 Pejë 2 vota, VP/18 Podujevë 1 votë, VP/19 Prishtinë 3 vota. VP/20 Prizren 1 votë, VP/22 Shtime 6 vota, VP/25 Ferizaj 45 vota. VP/26 Viti 1 votë, VP/27 Vushtrri 4 vota. Parashtruesi i ankesës ka theksuar po ashtu se edhe për kandidatin Etem Arifi me nr. 1 ka pasur orkestrim të votave të qytetarëve që banojnë në Gjermani dhe të cilët kanë prejardhje nga qytetet e Kosovës Lipjan dhe Shtime. Votat janë orkestruar përmes kësaj formë si marrjes se letërnjoftimit, hapjes se e-mailit dhe dëftesës nga Etem Arifi dhe votimi në grupacion. VP/13 Lipjan 55 vota, VP/22 Shtime 26 vota, VP/25 Ferizaj 11 vota.

Në ankesë kanë theksuar se, përveç kësaj formë të dëmtimit dhe tani shqetësimi i tyre është se janë dëmtuar edhe me votimin nga diaspora sepse provat të cilat i kanë mbledh tregojnë qartazi se këtu kemi të bëjmë me manipulim të votuesit të diasporës duke ju marr letërnjoftimet e tyre dhe duke i regjistruar ne pajisjet e tyre, duke u hap e-mail për ta (gjë që i ka bërë pronar dëftesash) dhe duke i votuar votat e tyre pa dijeninë e tyre. E kjo padyshim që nuk mund të quhet ndryshe përveç se orkestrim votash. Dhe se shpjegimin për PZAP e ndajnë në kë formë: Etem Arifi ka kërkuar letërnjoftime në rrjetin social për t'i regjistruar si votues dhe për këtë kanë provën si video dhe është e habitshme se pikërisht Etem Arifi ka 170 vota me postë dhe se janë të tipit çfarë po paraqesim përmes provës së videos. Çështja e dytë ka të bëjë me provën video të cilën e gjeni të bashkangjitur dhe se në video shihet qartazi (duke u votuar kandidati 2 (Artan Asllani) dhe kandidati 4 (Besart Jashari) dhe kjo formë e votimit në rezultatet e diasporës përputhet dhe se janë mbi 105 vota. Për të vërtetuar pretendimet e tyre si subjekt politik i koalicionit PDAK-LPB dhe se kemi të bëjmë me manipulim të vullnetit të votuesit nga PAI, gjegjësisht faktit se këta votues nuk kanë votuar fare ose nuk kanë shprehur mendimin e tyre as për subjektin politik dhe as për kandidatet që kane orkestruar votat si dëshmi kane emrat dhe mbiemrat e disa prej tyre që jetojnë në diasporë me prejardhje nga Kosova të cilët janë manipuluar nga PAI dhe prokuroria ka filluar hetimet. Përveç kësaj ne kemi edhe audioinqizim dhe video ku ata qartazi tregojnë se i kane dërguar letërnjoftimet, apo ja kane marr letërnjoftimet, ju ka hapur e-maili nga PAI dhe këta fare nuk kanë marr pjese në procesin e votimit. Andaj, me numërimin e votave të orkestruara, koalicioni PDAK-LPB përmbysset dhe del PAI si parti më e votuar, ndryshohet vullneti qytetarë i komunitetit Ashkali pasi që ne garojmë për vendin e garantuar në parlamentin e Republikës së Kosovës. Lidhur me dyshimet e kryerjes se veprave penale që lidhen me zgjedhjet dhe votimin ne kemi bere edhe kallëzim penal, te cilin ia bashkangjesim kësaj ankesë dhe prokuroria ka filluar hetimin e rastit.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP te anulohen 211 votat e PAI-se me poste nga diaspora.

Parashtruesi i ankesës po ashtu ka bashkangjitur prova lidhur me bazueshmërinë e ankesës së tij si:

Video e Etem Arifi duke kërkuar letërnjoftime për votuesit e diasporës, Video e duke u votuar vetëm kandidatët nr. 2 Artan Asllani dhe nr. 4 Besart Jashari në grupacion në diasporë ku video është publikuar edhe në media në Kosovë, Dëshmia e video e dëshmitares Sanije Irle ku dëshmon se ju kane marr letërnjoftimet e gjithë familjareve të tyre dhe janë manipuluar dhe orkestruar për vota, Audioinqizimi me të cilin ju kanë marr letërnjoftimi personit dhe nuk e ka ditur për çfarë arsye e jep letërnjoftimin dhe nuk ka pasur fare e-mail, Audio inqizimi i një qytetare nga Gjermani me banim në Ferizaj ku tregon që kandidati nr. 2 Artan Asllani dhe nr. 4 Besart Jashari kane shkuar në shtëpinë e saj në Gjermani dhe kane marr disa familje me një numër të madhe të tyre dhe i ka grumbulluar

letërnjoftime ima për të i regjistruar si votues dhe orkestrua votat mirëpo nuk ka bashkangjitur kallëzimin penal për te cilin pretendon më lartë në ankesë.

Në përgjigjen në ankesë nga KQZ theksohet se, pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e shkeljes së procesit të punës-administrimit të numërimit në QNR, mospërputhjes me ndonjë dokument siç janë, vëzhguesit e akredituar, Formularët e Rezultateve të subjekteve politike etje, por rezultate e votave të diasporës. Prandaj, pretendimet për rezultatet të QNR-së, për votat e diasporës me postë të datës 04.03.2025, të orës 16:09, nuk qëndrojnë, sepse këto nuk janë shpallje të rezultateve përfundimtare, por këto janë forma të rezultateve të plotësuara në QNR nga ekipet e numërimit dhe të gjithë të interesuarit kanë mund të shohin çdo ekspozim të fletëvotimeve në kamera dhe rezultatet e çdo fletëvotimi me postë dhe fletëvotimi të votimit në përfaqësitë diplomatike me qëllim të rritjes së transparencës së plotë të numërimit të votave në QNR.

Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe se pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, rezultati i publikuar është i ankueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Pra, duke ju referuar nenit 106 paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, "Personi fizik apo juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrajnë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij".

Bazuar në dispozitat ligjore në Ligji nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së përcakton se: PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj, në nenet 27,6, 39,3, 41.546, 51,4, 548, 69,7, 7715, 80,3, 942, 983, 100,3, 102,1, 103,4 dhe nenit 1051.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore Ligji nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në

Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/ L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nuk parashihet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen rezultatet e kësaj natyre të KQZ-së të plotësuara në QNR, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP.

Nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura në këtë përgjigje, pretendimet e palës ankuese nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe nuk janë të mbështetura nga ndonjë provë e qartë dhe bindëse. Për më tepër, ankesa në fjalë konsiderohet e palejuar, pasi nuk bie në kategorinë e vendimeve të KQZ-së që mund të ankimohen në PZAP.

Ndërsa sa i përket pretendimeve për orkestrimin i votave ku shihen qartë që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë, votimi në grupacione nga përfaqësues të PAI-të dhe

mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt me rezultatin e votimit dhe lidhur me kallëzimin penal të dorëzuar në prokurori, KQZ nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në procedurat hetimore të organeve të drejtësisë. Megjithatë, nëse kërkohet, KQZ është e gatshme të bashkëpunojë dhe të ofrojë çdo informacion të nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Andaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura si më sipër, si dhe dispozitat ligjore të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 119 paragrafi 3 kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) që pretendimet e palës ankuese t'i hedhë si të palejuara.

Paneli pas vlerësimit të ankesës, konstaton se:

- Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesë në PZAP me datë 05.03.2025, me të cilën pretendohet se subjekti politik PDAK-LPB i konteston votat e diasporës për subjektin PAI për këto arsye, orkestrimi i votave ku shihen qartë që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë, votimi në grupacione nga përfaqësues të PAI-së, mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga PAI. Subjekti politik PAI dhe anëtarët e saj kanë bërë orkestrim të votave duke ndikuar direkt të votuesit dhe kjo mund të vërtetohet duke marrë për bazë fletëvotimet në KQZ të ardhur përmes postes e ku shihet se aty janë votuar vetëm kandidatet Artan Asllani me nr. 2 dhe Besart Jashari nr. 4 nga subjekti i PAI-së. Nga përgjigja në ankesë nga KQZ në të cilën është theksuar se, pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e shkeljes së procesit të punës-administrimit të numërimit në QNR, mospërputhjes me ndonjë dokument siç janë, vëzhguesit e akredituar, Formularët e Rezultateve të subjekteve politike etje, por rezultate e votave të diasporës. Prandaj, pretendimet për rezultatet të QNR-së, për votat e diasporës me postë të datës 04.03.2025, të orës 16:09, nuk qëndrojnë, sepse këto nuk janë shpallje të rezultateve përfundimtare, por këto janë forma të rezultateve të plotësuara në QNR nga ekipet e numërimit dhe të gjithë të interesuarit kanë mund të shohin çdo ekspozim të fletëvotimeve në kamera dhe rezultatet e çdo fletëvotimi me postë dhe fletëvotimi të votimit në përfaqësitë diplomatike me qëllim të rritjes së transparencës së plotë të numërimit të votave në QNR. Paneli vlerëson se, nga përmbajtja e ankesës shihet se, pretendimet ankimore kanë të bëjnë me parregullsitë që kanë ndodhur nga data e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës dhe votimi në grupacione, nga kjo rezulton që ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës.

Me dispozitën e nenit 119, paragrafi 1 të LZP-së, parashihet që: “ Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrtojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj.” Në rastin konkret afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e

shkeljes së supozuar, lidhur me parregullsitë për të cilat pretendon pala ankuese për orkestrimin e votave, votimi në grupacione nga përfaqësuesi i PAI-së, mosrespektim të vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga PAI, kjo periudhë rezulton të jetë nga muaji Gusht 2024 deri në muajin Dhjetor 2024 dhe ditën e votimit datë 08.02.2025, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 05.03.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Me dispozitën e nenit 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive parashihet që: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”*, ndërsa nënparagrafi 3.3 parasheh që: *“nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*, andaj, lidhur me ankesën e lartë përmendur, Paneli ka vendosur që të hedhë si të pasafateshme.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.631/2025 datë 07.03.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME

AA.nr.55/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Franciska Zhitija-Ymeri dhe Muhamet Rexha anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Ferizaj, të parashtruar kundër subjektit politik: Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Ferizaj, ndaj rezultateve të Qendrës së Numërimit të Votave (QNR), për numërimin e votave e diasporës me Postë, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09 Shkurt 2025, në vendosje sipas ankesës së PDAK, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A nr.631/2025, të datës 07.03.2025, në seancën e mbajtur më datë 12.03.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Ferizaj, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.631/2025, të datës 07.03.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.631/2025, të datës 07.03.2025, është vendosur: HEDHET E PASAFATSHME ankesa A.nr.631/2025, e datës 05.03.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, kundër subjektit politik Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj, ndaj rezultateve të QNR-së për votat e diasporës me postë të datës 04.03.2025 të orës 16:09, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025.

Kundër këtij vendimi, subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes së të drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës, ta, Aprovojë ankesën e parashtruar në këtë gjykatë më datë 11.03.2025, të Ndryshojë vendimin Anr.631/2025, të datës 07.03.2025, ashtu që të: Anulohen 211 (dyqind e njëmbëdhjetë) votat e Diasporës me postë për Partinë e Ashkalinjëve për Integrim (PAI).

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e subjektit politik: Partia Demokratike



Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.631/2025, i datës 07.03.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se më datë 05.03.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër Anr.631/2025, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komunën Ferizaj, të parashtruar kundër subjektit politik, Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komunën Ferizaj.

Në ankesën e ushtruar në PZAP, subjekti politik: PDAK-LPB, i konteston votat e diasporës me postë për subjektin politik Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), mbi bazën e këtyre arsyeve: Orkestrimi i votave ku shihen qartë që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë; votimi në grupacione nga përfaqësues të PAI-së, mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga PAI. Subjekti politik PAI dhe anëtarët e saj kanë bërë orkestrim të votave duke ndikuar direkt të votuesit dhe kjo mund të vërtetohet duke marrë për bazë fletëvotimet në KQZ të ardhur përmes postës e ku shihet se aty janë votuar vetëm kandidatët Artan Asllani me nr. 2 dhe Besart Jashari nr.4 nga subjekti i PAI-së. PZAP mund të marrë votat në qendrën e numërimit sipas vendvotimeve si: VP/06 Istog 3 vota, VP/08 Klinë 3 vota, VP/09 Fushë Kosovë 30, VP/II Mitrovicë e Jugut 4 vota, VP/13 Lipjan 12 vota, VP/ 15 Obiliq 4 vota, VP/ 17 Pejë 2 vota, VP/ 18 Podujevë I votë, VP/ 19 Prishtinë 3 vota. VP/20 Prizren 1 votë, VP/22 Shtime 6 vota, VP/25 Ferizaj 45 vota. VP/26 Viti 1 votë, VP/27 Vushtrri 4 vota. Parashtruesi i ankesës ka theksuar po ashtu se edhe për kandidatin Etem Arifi me nr. 1 ka pasur orkestrim të votave të qytetarëve që banojnë në Gjermani dhe të cilët kanë prejardhje nga qytetet e Kosovës Lipjan dhe Shtime. Votat janë orkestruar përmes kësaj forme si marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga Etem Arifi dhe votimi në grupacion. VP/ 13 Lipjan 55 vota, VP/22 Shtime 26 vota, VP/25 Ferizaj 11 vota.

Në vazhdim në ankesë ka theksuar se: përveç kësaj forme të dëmtimit dhe tani shqetësimi i tyre është se janë dëmtuar edhe me votimin nga diaspora sepse provat të cilat i kanë mbledhë tregojnë qartazi se këtu kemi të bëjmë me manipulim të votuesit të diasporës duke ju marrë letërnjoftimet e tyre dhe duke i regjistruar në pajisjet e tyre, duke u hapur e-mail për ta (gjë që i ka bërë pronar dëftesash) dhe duke i votuar votat e tyre pa dijeninë e tyre. E kjo padyshim që nuk mund të quhet ndryshe përveç se orkestrim votash, dhe se shpjegimin për PZAP e ndajnë në këtë formë: Etem Arifi ka kërkuar letërnjoftime në rrjetin social për t'i regjistruar si votues dhe për këtë kanë provën si video dhe është e habitshme se pikërisht Etem Arifi ka 170 vota me postë dhe se janë të tipit çfarë po paraqesim përmes provës së videos. Çështja e dytë ka të bëjë me provën video të cilën e gjeni të bashkangjitur dhe se në video shihet qartazi (duke u votuar kandidati 2 (Artan Asllani) dhe kandidati 4 (Besart Jashari) dhe kjo formë e votimit në rezultatet e diasporës përputhet dhe se janë mbi 105 vota. Për të vërtetuar pretendimet e tyre si subjekt politik i koalicionit PDAK-LPB dhe se kemi të bëjmë me manipulim të vullnetit të votuesit nga PAI, gjegjësisht faktit se këta votues nuk kanë votuar fare ose nuk kanë shprehur mendimin e



tyre as për subjektin politik dhe as për kandidatët që kanë orkestruar votat si dëshmi kanë emrat dhe mbiemrat e disa prej tyre që jetojnë në diasporë me prejardhje nga Kosova të cilët janë manipuluar nga PAI dhe prokuroria ka filluar hetimet. Përveç kësaj në kemi edhe audio-incizim dhe video ku ata qartazi tregojnë se i kanë dërguar letërnjoftimet, apo ja kanë marr letërnjoftimet, ju ka hapur e-maili nga PAI dhe këta fare nuk kanë marr pjesë në procesin e votimit. Andaj, me numërimin e votave të orkestruara, koalicioni PDAK-LPB përmbysset dhe del PAI si parti më e votuar, ndryshohet vullneti qytetarë i komunitetit Ashkali pasi që ne garojmë për vendin e garantuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës. Lidhur me dyshimet e kryerjes së veprave penale që lidhen me zgjedhjet dhe votimin, ka theksuar se kanë bërë edhe kallëzim penal, të cilin ia bashkëngjisim kësaj ankesë dhe prokuroria ka filluar hetimin e rastit. Në fund, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP të anulohen 211 votat e PAI-së me postë nga diaspora, për të cilat thekson se ka bashkangjitur edhe provat.

Më datë 05.03.2025, PZAP-i, njoftoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë deri më 06.03.2025 në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të paraqitur më datë 06.03.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e shkeljes së procesit të punës administrimit të numërimit në QNR, mospërputhjes me ndonjë dokument siç janë, vëzhguesit e akredituar, Formularët e Rezultateve të subjekteve politike etje, por rezultate e votave të diasporës. Prandaj, pretendimet për rezultatet të QNR-së, për votat e diasporës me postë të datës 04.03.2025, të orës 16:09, nuk qëndrojnë, sepse këto nuk janë shpallje të rezultateve përfundimtare, por këto janë forma të rezultateve të plotësuar në QNR nga ekipet e numërimit dhe të gjithë të interesuarit kanë mund të shohin çdo ekspozim të fletëvotimeve në kamera dhe rezultatet e çdo fletëvotimi me postë dhe fletëvotimi të votimit në përfaqësitë diplomatike me qëllim të rritjes së transparencës së plotë të numërimit të votave në QNR. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe se pas përfundimit të gjitha procedurave në QNR, rezultati i publikuar është i ankueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Ka shtuar se: Duke ju referuar nenit 106 paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, *"Personi fizik apo juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojnë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij"*. Bazuar në dispozitat ligjore në Ligjin nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së përcakton se: PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj, në nenet 27,6, 39,3, 41.546, 51,4, 548, 69,7, 7715, 80,3, 942, 983, 100,3, 102,1, 103,4 dhe nenit 1051. Nga interpretimi i dispozitave ligjore Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/ L-012 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nuk parashihet me asnjë dispozite ligjore se mund



të ankimohen rezultatet e kësaj natyre të KQZ-së të plotësuar në QNR, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP.

Andaj, duke u nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura në këtë përgjigje, pretendimet e palës ankuese nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe nuk janë të mbështetura nga ndonjë provë e qartë dhe bindëse. Për më tepër, ankesa në fjalë konsiderohet e palejuar, pasi nuk bie në kategorinë e vendimeve të KQZ-së që mund të animohen në PZAP. Ndërsa sa i përket pretendimeve për orkestrimin e votave ku shihen qartë që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë, votimi në grupacione nga përfaqësues të PAI-të dhe mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt me rezultatin e votimit dhe lidhur me kallëzimin penal të dorëzuar në prokurori, KQZ nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në procedurat hetimore të organeve të drejtësisë. Megjithatë, nëse kërkohet, KQZ është e gatshme të bashkëpunojë dhe të ofrojë çdo informacion të nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Andaj, kanë kërkuar nga PZAP, që ankesën A.nr.631/2025, të datës 05.03.2025, të parashtuara nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, A.nr.631/2025, të datës 07.03.2025, t'a hudhë të pasafatshme ndërsa vendimi i ankimuar të vërtetohet si i bazuar.

PZAP, pas analizimit të pretendimeve si në ankesë përgjigjes në ankesë të KQZ, vendos si në dispozitiv të vendimit të saj. Në arsyetim të vendimit, ndër të tjera ka theksuar se: parashtuesi i ankesës ka dorëzuar ankesë në PZAP me datë 05.03.2025, me të cilën pretendohet se subjekti politik PDAK-LPB i konteston votat e diasporës për subjektin PAI për këto arsye, orkestrimi i votave ku shihen qartë që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë, votimi në grupacione nga përfaqësues të PAI-së, mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga PAI. Subjekti politik PAI dhe anëtarët e saj kanë bërë orkestrim të votave duke ndikuar direkt të votuesit dhe kjo mund të vërtetohet duke marr për bazë fletëvotimet në KQZ të ardhur përmes postës e ku shihet se aty janë votuar vetëm kandidatët Artan Asllani me nr. 2 dhe Besart Jashari nr. 4 nga subjekti i PAI-së. Nga përgjigja në ankesë nga KQZ në të cilën është theksuar se, pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e shkeljes së procesit të punës-administrimit të numërimit në QNR, mospërputhjes me ndonjë dokument siç janë, vëzhguesit e akredituar, Formularët e Rezultateve të subjekteve politike etje, por rezultate e votave të diasporës. Prandaj, pretendimet për rezultatet të QNR-së, për votat e diasporës me postë të datës 04.03.2025, të orës 16:09, nuk qëndrojnë, sepse këto nuk janë shpallje të rezultateve përfundimtare, por këto janë forma të rezultateve të plotësuar në QNR nga ekipet e numërimit dhe të gjithë të interesuarit kanë mund të shohin çdo ekspozim të fletëvotimeve në kamera dhe rezultatet e çdo fletëvotimi me postë dhe fletëvotimi të votimit në përfaqësitë diplomatike me qëllim të rritjes së transparencës së plotë të numërimit të votave në QNR. Paneli vlerëson se, nga përmbajtja e ankesës shihet se, pretendimet ankimore kanë të bëjnë me parregullsitë (që kanë ndodhur nga data e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës dhe votimi në grupacione, nga kjo rezulton që ankesa është parashtuar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtuar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli Ferizaj, është parashtuar pas afatit ligjor të rregulluar me nenin 39, par. 3 të LZP, në të cilin nën në mënyrë decidive thuhet se: *"Personi i cili ka interes ligjor në"*



një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar..." ndërsa në nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, në mënyrë decisive thuhet se: *"Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrijë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj"*, si dhe në nenin 13, paragrafi 3. nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive thuhet se: *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor"*. Në rastin konkret afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar lidhur me parregullsitë për të cilat pretendon pala ankuese për orkestrim të votave ,votimi në grupacion nga përfaqësuesi i PAI-së mosrespektim të vullnetit të qytetarit dhe duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit për mes marrjes së letërnjoftimit ,hapjes së emailit dhe dëftesës nga PAI, kjo periudhë rezulton të jetë nga muaji Gusht 2024, deri në muajin Dhjetor 2024 dhe ditën e votimit 08.02.2025, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP me datë 05.03.2025, që donë të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025.

Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 05.03.2025, ndërsa parregullsitë me të cilin pretendon pala ankuese janë nga muaji shtator 2024 deri në ditën e zgjedhjeve më datë 09.02.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit ligjor të paraparë me nenin 39 paragrafi 3 dhe nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së.

Me nenin 39 paragrafi 3 përcaktohet se: *"Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i do të vendosë për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj"*.



Me nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrijë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”*. Prandaj nga kjo rrjedhë se vendimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Me nenin 13 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijs së Ankesave të PZAP-it, me të cilën përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.3. nuk është dorëzuar në afatit e paraparë ligjor”*.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve, (PDAK) - LPB, Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e këtij subjekti janë në tërësi të pa themelta, kjo ngase nga shkresat e lëndës shihet se parashtruesi ankesën në PZAP, e ka parashtruar më datë 05.03.2025, ndërsa pretendimet për rezultatet të QNR-së, për votat e diasporës me postë të datës 04.03.2025, të orës 16:09, nuk qëndrojnë, sepse këto nuk janë shpallje të rezultateve përfundimtare, por këto janë forma të rezultateve të plotësuar në QNR nga ekipet e numërimit dhe të gjithë të interesuarit kanë pasur mundësi të shohin çdo ekspozim të fletëvotimeve në kamera dhe rezultatet e çdo fletëvotimi me postë dhe fletëvotimi të votimit në përfaqësitë diplomatike me qëllim të rritjes së transparencës së plotë të numërimit të votave në QNR. Nga përmbajtja e ankesës, sipas objektit lëndor të saj, rezulton se ankesa kundër subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orëve nga ndodhja e disa shkeljeve të pretenduara nga pala ankuese të cekura si më lartë dhe në ankesë dhe si në vendimin e ankimuar të PZAP, lidhur me pa rregullsitë e ndodhura në periudha para zgjedhjeve dhe në ditën e votimit. Andaj me të drejtë PZAP e ka hedhë poshtë ankesën si të pas afatshme bazuar në dispozitat e LZP-së.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 39 paragrafi 3 dhe nenin 119 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË


AA.nr.55/2025, me 12 mars 2025

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Punëtori i autorizuar
Ovlašćen radnik